

RAPORT PËRMBLEDHËS I MONITORIMIT  
**Qeverisja e mirë nuk është fjalë goje**  
*Shtator 2012, Prizren*

## PËRMBAJTJE

I. Përmbledhje Ekzekutive .....	2
II. Për projektin .....	4
III. Pse monitorim i transparencës .....	5
IV. Konstatime të përgjithshme mbi transparencën komunale .....	5
V. Të gjeturat specifike të monitorimit .....	7
VI. Ndikimi i projektit .....	10
VII. Rekomandime të përgjithshme (transparenca) .....	12
VIII. Rekomandime specifike (sektorale) .....	13
IX. Faza e dytë .....	15
X. Falënderim.....	15
EC Ma Ndryshe.....	16

*Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit "Transparenca online e komunës së Prizrenit", i përkrahur financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur*

## I. Përmbledhje ekzekutive

Ky raport përmbledh punën gjashtë mujore të monitorimit në kuadër të projektit “Transparenca online e komunës së Prizrenit”. Të gjeturat e monitorimit gjatë kësaj periudhe janë edhe një dëshmi e formë se qeverisja e mirë nuk është fjalë goje, por veprim këmbëngulës në drejtim të demokracisë dhe cilësisë së mirë të jetesës për qytetarët. Qeverisja e mirë, sa më shumë prezente në deklarat e zyrtarëve, aq më pak prezente në veprimet e tyre.

Qeverisja lokale në Prizren vuan nga shumë të meta strukturore. Transparenca, si parim themelor i qeverisjes së mirë, pa dyshim se renditet në krye të kësaj liste. Kohëve të fundit, gjithnjë e më shumë po kuptohet rëndësia e ndërtimit të transparencës në nivel lokal si mjet për trajtimin e disa nga sfidave më të mëdha për zhvillimin e qëndrueshëm dhe demokracinë. Konstatimet e përgjithshme mbi transparencën lokale: Rregullorja për Transparencë, joobligative për ekzekutivin, Vonesa të panevojshme për qasje në dokumente, Mbyllja e takimeve të kryetarit me drejtorët paraqet dëmtim të demokracisë, Shumë zyrtarë nën hetime, Qytetarët larg vendimmarrjes.

Të gjeturat specifike të monitorimit përfshijnë: Kryetari i komunës nuk ka plan vjetor të punës, Vendimet publikohet në formë të përgjithësuar, Drejtorët e shkollave, menaxherë të paafte buxheti, Cilësi e dobët e investimeve kapitale në shkolla, Shërbime jocilësore shëndetësore, Rreth 80% e ndërtimeve nuk i përmbahen lejeve të ndërtimit, Qyteti i kulturës pa politika kulturore, Auditori konfirmon shqetësimet e shoqërisë civile për keqmenaxhim financiar, Degradimi urban i qytetit (hetime në urbanizëm), Degradimi urban i qytetit – raste konkrete (objekte të banimit kolektiv),

Degradimi urban i qytetit – raste konkrete (Qendra Historike), Shpenzime marramendëse për udhëtime zyrtare, Shpenzimi i pak kontrolli i parasë publike, Shpenzimet e luksit v gjendja socio-ekonomike e qytetarëve.

Faza e parë, gjashtëmujore e projektit ka prodhuar disa rezultate të mira, të cilat janë indikatorë pozitiv për efekte më të mëdha në fazat e ardhshme të projektit. Në të njëjtën kohë, rezultatet e para janë dëshmi e mirë për nevojën e monitorimit permanent dhe intensiv të ekzekutivit komunal në Prizren. Ndikimi i fazës së parë të projektit është vërejtur në mbulesën mediale të ofruar për të gjeturat dhe aktivitetet e projektit, interesimin e qytetarëve për të raportuar raste të keqpërdorimit të pozitës zyrtare, nisjen e hetimeve në urbanizëm, interesimin e Ministrisë së Kulturës për situatën e krijuar në Qendrën Historike dhe numrin e vizitave (klikimeve) në web-faqen e projektit.

Për të adresuar të metat e përgjithshme të qeverisjes transparente, rekomandojmë:

- Amendamentimin e Rregullores për Transparencë,
- Anulimin e vendimit për takimet e mbyllura të kryetarit me drejtorët,
- Ndërmarrjen e masave ndëshkuese ndaj zyrtarëve komunalë që shkelin Ligjin për Qasje në Dokumente Publike,
- Publikimin e të gjitha akteve në formën e tyre preliminare si dhe përfundimtare në web-faqen e komunës,
- Amendamentimin e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale në raport me mbikëqyrjen e punës së kryetarit të komunës,
- Angazhimin më serioz të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për

mbikëqyrjen e ligjshmërisë në komunën e Prizrenit,

- Promovimin e mekanizmave të pjesëmarrjes qytetare,
- Rritjen e numrit të OshC-ve që monitorojnë qeverjsen lokale,
- Përfshirjen substanciale të qytetarëve në hartimin e buxhetit vjetor komunal,
- Raportim të rregullt medial të të gjitha veprimeve që bien ndesh me transparencën,
- Hetimin nga Prokuroria e Qarkut e të gjitha rasteve të raportuara të keqpërdorimeve,
- Funkcionalizimin e Zyrës për Informim të komunës, dhe
- Themelimin e Zyrës për Hulumtime dhe Opinion Publik.

Rekomandimet specifike (sektorale):

- Kryetari i Prizrenit të ketë Plan të Punës,
- Të mbikëqyrret menaxhimi financiar nëpër shkolla,
- Të hetohen rastet e prishjeve në objektet e reja shkollore,
- Të sanohet gjendja në ofrimin e shërbimeve mjekësore,
- Të rrënohen ndërtimet jashtë kriterëve,
- Koordinim mes urbanizmit dhe inspektorarit për normalizimin e gjendjes në Qendrën Historike,
- IMMK Prizren të jetë më rigjide në dhënien e pëlqimeve,
- Të hartohet Strategjia për Kulturën,
- Të zbatohen rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm,
- Të reduktohen shpenzimet për udhëtime zyrtare të panevojshme,
- Të ndërpritet praktika e përvetësimit dhe devalvimit të parasë publike

## II. Për projektin

Ekzekutivi i komunës, i cili tashmë udhëhiqet nga kryetari i komunës (i cili i emëron dhe shkarkon drejtorët komunalë sipas vullnetit të tij personal), po promovon një cilësi të re të qeverisjes lokale dhe të ofrimit të shërbimeve publike. Ndonëse ky ndryshim cilësor nuk është gjithmonë cilësor, ekzekutivi i komunës (sidomos kryetari) po shndërrohet në adresën e vetme të përgjegjësive, dhe si pasojë të llogaridhënies, në raport me qeverisjen e mirë dhe shërbimet cilësore publike. Mbikëqyrja e punës së kryetarit (sidomos pjesa e ligjshmërisë) është ndër sfidat më të mëdha të qeverisjes lokale në Kosovë. Derisa Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal vlerësohet jo mjaftueshëm efektive, as Kuvendet Komunale dhe sistemi gjyqësor nuk dëshmojnë për cilësi më të larta. Dimensioni i fundit i kësaj mbikëqyrjeje, kontrolli qytetar, krahas pengesave politike, po has edhe në absurditete ligjore (Neni 72 i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale për largimin e kryetarit nga detyra).

Janë evidentuar shumë raste gjatë këtyre dy mandateve të fundit, kur Kryetarë komunash kanë vepruar pa konsultim paraprak me Kuvendin Komunal dhe në shumë raste pa vendim të këtij organi. Kjo praktikë ka ngritur shqetësime të shumta në raport me respektimin e ligjit nëpër komunat e Kosovës. Përkrahësit e sistemit mayoral janë të vetëdijshëm për formulën e dëmtimit të demokracisë në nivel lokal. Kjo formulë arrihet kur Kryetari i komunës tregohet shumë i sofistikuar në aftësitë e tij manipuluese, derisa në të njëjtën kohë Kuvendi Komunal tregohet i ngathtë në përmbushjen e obligimeve dhe ushtrimin e plotë të kompetencave (ligjore dhe mbikëqyrëse). Disa nga rastet e keqpërdorimit të pushtetit ekzekutiv janë shfaqur në komunën

e Prizrenit, derisa për njërin nga këta raste EULEX aktualisht është duke zhvilluar hetime ndaj kryetarit të komunës së Prizrenit. Për këtë arsye, monitorimi dhe raportimi për aktivitetet e keqqeverisjes (sidomos të ekzekutivit të komunës) do të duhej të ishte detyrë primare e shoqërisë civile në raport me qeverisjen e mirë në nivel lokal.

Transparenca online e komunës së Prizrenit është projekt për monitorimin e punës së organeve komunale. Fokusi themelor i monitorimit është ekzekutivi i komunës (kryetari i komunës dhe drejtoritë) si dhe shërbimi civil. Monitorimi përformohet përmes monitoruesve permanentë, të cilët kenë prezencë të rregullt në zyrat komunale dhe qasje të papenguar në dokumentet zyrtare të komunës. Raportimi i të gjeturave të monitorimit përdorë gjithashtu një mekanizëm permanent, web-faqen e transparencës së qeverisjes lokale. Të gjeturat e monitorimit postohen drejtpërdrejtë në web-faqen e projektit, për të krijuar mundësi qasjeje për të gjitha palët e interesuara. Të gjeturat e monitorimit janë bazë e veprimit për nivelin e dytë të aktiviteteve të projektit, avokimin dhe adresimin e shkeljeve ligjore. EC Ma Ndryshe përdorë mundësitë ligjore për të nisur procedura të adresimit të shkeljeve ligjore nga ana e komunës.

Qëllimi themelor i projektit do të jetë forcimi i qeverijes së mirë në komunën e Prizrenit. Objektivat specifike që do të ndihmojnë arritjen e këtij qëllimi janë: Përmirësimi i nivelit të informimit të përgjithshëm të publikut mbi vendimmarrjen locale, Aktivizimi i mekanizmave qeveritarë dhe gjyqësorë për adresimin e praktikave që çenojnë ligjshmërinë, Rritja e nivelit të transparencës komunale në vendimmarrje, Rritja e vigjilencës së

vendimmarrësve lokalë në raport me respektimin e ligjshmërisë në qeverisjen lokale, Rritja e pjesëmarrjes së grupeve të komunitetit në vendimmarrjen lokale.

### III. Pse monitorim i transparencës?

Në dekadën e kaluar fokusi ndaj transparencës, si një aspekt i përmirësimit të qeverisjes dhe luftës kundër korrupsionit, ka qenë në nivel kombëtar, që lidhet kryesisht me prirjet globale të pluralizimit, demokratizimit dhe përmirësimit të qeverisjes. Në një aspekt, kjo është e kuptueshme, pasi që korrupsioni - pasojë më e shpikatur e mungesës së transparencës - shpesh është më i dukshëm në nivel kombëtar, dhe për shkak se institucionet e legjislativit, ekzekutivit apo gjyqësorit kanë qenë pikë tradicionale e referencës për luftimin e korrupsionit. Kohët e fundit, megjithatë, ekziston një ndryshim në drejtim të rritjes së transparencës në nivel lokal. Gjithnjë e më shumë po kuptohet rëndësia e ndërtimit të transparencës në nivel lokal si mjet për trajtimin e disa nga sfidave më të mëdha për zhvillimin e qëndrueshëm dhe demokracinë.

Janë dy aspekte themelore të qeverisjes (dhe qeverisjes së mirë). Së pari, koncepti i qeverisjes është më i gjerë se qeveria. Në kontekstin urban, kjo do të thotë se përgjegjësia për menaxhimin e çështjeve të një qytetit nuk është e kufizuar në pushtetin lokal, por përfshin një shumëllojshmëri të gjerë të palëve të interesuara, duke përfshirë: qeverinë qendrore dhe lokale, sektorin privat, organizatat e shoqërisë civile dhe ato të bazuara në komunitet, mediet, shoqatat profesionale dhe anëtarë të tjerë të shoqërisë civile. Së dyti, koncepti i qeverisjes fokusohet në institucionet dhe proceset. Në kontekstin e burimeve të pakta, që konkurrojnë, por të vlefshme,

prioritetet duhet të vendosen me anë të proceseve që përfshijnë të gjitha palët e interesuara në vendimmarrje. Kjo ka implikime të rëndësishme për zhvillimin e një kornize për promovimin e transparencës në nivel lokal. Transparenca në proceset vendimmarrëse dhe në institucione ka potencial të bëhet një strategji qendrore për t'u angazhuar aktorët, luftën kundër korrupsionit dhe përmirësimin e cilësisë së qeverisjes urbane në përgjithësi.

Prandaj, transparenca paraqet parimin thelbësor të qeverisjes së mirë. Qasja e lirë në informata luan një rol të rëndësishëm në promovimin e transparencës. Informacioni, megjithatë, duhet të jepet në kohë, tëp jetë relevant, i saktë dhe i plotë për t'u përdorur në mënyrë efektive. Çështjet se kush e prodhon atë informacion, dhe për çfarë qëllimi, bëhen aspekte kyçe të transparencës, kur interesat konkurren të konvergojnë në një çështje të veçantë. Një nga modelet më të avancuara për sigurimin e transparencës është korniza pesë-pikëshe për rritjen e transparencës: 1. Vlerësim dhe monitorim, 2. Qasje në informacion, 3. Etikë dhe integritet, 4. Reformë institucionale dhe 5. Trajtimi i çështjeve specifike.

### IV. Konstatime të përgjithshme mbi transparencën komunale

Qeverisja lokale në Prizren vuan nga shumë të meta strukturore. Transparenca, si parim themelor i qeverisjes së mirë, pa dyshim se renditet në krye të kësaj liste. Kohëve të fundit, gjithnjë e më shumë po kuptohet rëndësia e ndërtimit të transparencës në nivel lokal si mjet për trajtimin e disa nga sfidave më të mëdha për zhvillimin e qëndrueshëm dhe demokracinë. Më poshtë, disa nga konstatime të përgjithshme mbi transparencën komunale, të

dala nga procesi gjashtë mujor i monitorimit të ekzekutivit komunal në Prizren.

*Rregullorja për Transparencë, joobligative për ekzekutivin* – Rregullorja për Transparencë e komunës së Prizrenit, në formën që e ka miratuar Kuvendi i Komunës, është totalisht joobligative për kryetarin e komunës dhe ekzekutivin komunal. Prandaj, një rregullore e këtillë, ku nuk specifikohen obligimet e ekzekutivit komunal paraqet një ikje të qëllimshme nga përgjegjësia dhe llogaridhënia. Për më tepër, ajo e redukton transparencën vetëm në nivel të Kuvendit të Komunës. Me këtë përmbajtje të Rregullores, jo vetëm që nuk do të promovohet transparencja komunale, por edhe kryetarit të komunës do t'i krijohet një alibi e fortë për t'u amnistuar nga kritikrat për mungesë të transparencës.

*Qasja në dokumente, vonesa të panevojshme* – Një e metë tjetër e qeverisjes së mirë në komunën e Prizrenit është shkelja e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike. Sipas raporteve të organizatave hulumtuese, gjendja më e keqe në fushën e qasjes në dokumente publike është në nivelin komunal, ndërsa komuna e Prizrenit rradhitet në nivele mjaft të ulëta të këtij vlerësimi. Për më tepër, web-faqja e komunës përmban vetëm informacion protokollar, ndërsa aty postohen vetëm vendimet e marra në formën e tyre përfundimtare. Kjo praktikë është në kundërshtim me kërksat e qeverisjes demokratike për krijimin e mundësive për pjesëmarrje dhe ndikim qytetar në marrjen e vendimeve edhe gjatë procesit të hartimit së politikave.

*Mbyllja e takimeve të kryetarit me drejtorët, dëmtim i demokracisë* – Për të dëmtuar edhe më tej nivelin e transparencës, përmes një vendimi kundërthënës dhe tejet dëmtues për demokracinë lokale, kryetari aktual i komunës

ka mbyllur për publikun takimet e tij me drejtorët komunalë (dikur Bordi i Drejtorëve). Mbyllja e takimeve ku merren vendime të rëndësishme rreth shpenzimit të buxhetit komunal, ka ngritur shumë dyshime për aftësinë e ekzekutivit komunal për të menaxhuar në mënyrë të drejtë me parane publike. Raporti i auditimit për vitin 2011, ka zbuluar se komuna e Prizrenit i shkel parimet e qeverisjes së mirë në raport me parane publike.

*Shumë zyrtarë nën hetime* – Një nga të metat e identifikuar është edhe menaxhimi i keq me pronën komunale. Shoqëria civile dhe opozita në Prizren në shumë raste kanë akuzuar kryetarin e komunës për uzurpim të kompetencave të Kuvendit Komunal, sidomos për vendimet rreth menaxhimit me pronën komunale. Janë shumë të rralla rastet kur autoritetet lokale ose qendrore të Kosovës kanë ndërmarrë veprime ndëshkuese ndaj Kryetarëve që e shkelin ligjin. Prizreni është ndër komunat me numër më të madh zyrtarësh të hetuar nga Prokuroria e Qarkut dhe EULEX për keqpërdorim detyre.

*Vendimmarrja qytetare, as që bëhet fjalë* – Qytetarët e komunës së Prizrenit edhe më tutje nuk janë pjesë e politikëbërjes lokale dhe përfshirja e tyre në procesin e konsultimeve është tepër e rrallë ose vetëm formale. Mekanizmat e demokracisë direkte, të cilat parashihen me Ligjin për Vetëqverisjen Lokale dhe Statutin e komunës së Prizrenit janë mundësi e pashfrytëzuar deri tani në komunën e Prizrenit. Në anën tjetër, komuna e Prizrenit po dëshmon paaftësi totale në përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje përmes konsultimeve publike, takimeve publike, buxhetimit me pjesëmarrja dhe komiteteve konsultative.

## V. Të gjeturat specifike të monitorimit

Gjatë fazës së parë të projektit janë monitoruar disa sfera të qeverisjes lokale. Më poshtë, të gjeturat specifike në monitorimit për sferat e urbanizmit, arsimit, shëndetësisë, kulturës dhe buxhetit.

*Kryetari i komunës nuk ka plan vjetor të punës* – Kërkesa e parë për qasje në dokumente publike dhe informata të punës së ekzekutivit të komunës së Prizrenit ka rezultuar me shkelje të Ligjit për qasjen në dokumente publike nga Kryetari i komunës dhe Drejtoria për Shëndetësi. Nga mospërgjigjia mund të konstatohet se Kryetari i komunës së Prizrenit nuk ka Plan Vjetor të Punës dhe ekzekutivin e komunës e udhëheq pa planifikim. Nëse ky konstatim nuk qëndron, ne i bëjmë thirrje Kryetarit të komunës që të na ofrojë qasje në Planin e tij të Punës.

*Vendimet publikohet në formë të përgjithësuar* – Publikimin e vendimeve në mënyrë të përgjithësuar e konsiderojmë jo efektiv pasi nuk specifikohet se si rezultat i të cilave politika kanë ardhë. Pas publikimit të vendimeve në mënyrë të përgjithësuar nga Kryetari i Komunës as drejtorët e drejtorive komunale nuk shqetësohen për publikimin preliminar të vendimeve të tyre në ueb faqen e komunës. Në këtë mënyrë, qytetarëve u pamundësohet që të jenë pjesëmarrës në hartimin e politikave dhe marrjen e vendimeve. Kjo praktikë është në kundërshtim të plotë me parimet e transparencës dhe llogaridhënies së ekzekutivit komunal.

*Drejtorët e shkollave, menaxherë të paaftë buxheti* – Në bazë të Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës, autoriteti kontraktues është i obliguar që të dërgojë njëkohësisht, së paku tre (3) operatorëve ekonomik një kërkesë me

shkrim për kuotimin e çmimeve dhe aq sa është e mundshme, sa më shumë operatorëve ekonomik, për të siguruar se konkurrenca efektive për kontratën përkatëse nuk dëmtohet. Drejtorët e shkollave në Prizren nuk e respektojnë këtë dispozitë ligjore dhe për më tepër nga ana e vetë drejtorëve kërkohet që kompania t'i sigurojë ofertat me qëllim të mbulimit të procedurave me letra. Po ashtu nga vetë drejtorët është pohuar se nuk kanë aftësim të duhur për të menaxhuar me sukses buxhetin e shkollës, duke e vënë theksin edhe në mungesën e një zyrtari financiar në shkollë.

*Cilësi e dobët e investimeve kapitale në shkolla* – Gjatë monitorimit të sektorit të arsimit është vërejtur edhe cilësi e dobët në investimet kapitale në shkolla. Disa nga objektet shkollore që janë ndërtuar së fundmi nuk janë të cilësisë së duhur. Çarjet e mureve të shkollave, prishjet e nyejve sanitare në objektet shkollore janë ndër problemet më kronike që përcjellin investimet në këtë lëmi. Mungesa e llogaridhënies dhe pranimet teknike pa ndonjë kriter nga ana e organit mbikëqyrës (komuna) kundrejt operatorëve ekonomik për objektet shkollore të investuara tregon për keqpërdorimet e mundshme nga ana e zyrtarëve të qeverisë lokale.

*Shërbime jociësore shëndetësore* – Një tjetër segment i monitorimit, ai i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, tregon për mungesën e cilësisë së këtyre shërbimeve të ofruara për qytetarët e Prizrenit. Pauzat e gjata të stafit mjekësor, detyrimi për caktimin e terminit për analizat e gjakut (dy apo tri ditë përpara) si dhe mungesa e barnave të listës esenciale janë dëshmi që kujdesi primar shëndetësor është në gjendje jo të mirë. Prandaj, qeveria lokale bashkë me stafin drejtues të institucioneve të shëndetit primar



duhet të ndërmarrë veprime të menjëhershme për sanimin e kësaj gjendjeje në ofrimin e shërbimeve mjekësore për qytetarët e Prizrenit.

*Rreth 80% e ndërtimeve nuk i përmbahen lejeve të ndërtimit* – Gjendjen e krijuar në sektorin e urbanizmit dhe planifikimit hapësinor në qytetin e Prizrenit është shqetësuese. Rreth 80% e ndërtimeve nuk i janë përmbajtur lejes së ndërtimit. Për më tepër, tendencat për pazarllëqe të ndryshme me kompanitë ndërtimore janë fenomeni dominues i projekteve urbanistike të financuara nga buxheti i komunës së Prizrenit. Dëshmia më e mirë për degradimin urbanistik të Prizrenit është shkresa zyrtare me Nr. 04-353 e Drejtorisë së Urbanizmit drejtuar Drejtorisë së Inspektoratit, në të cilin, në mes tjerash thuhet se “në bazë të evidencës që posedon shërbimi i DUPH ju njoftojmë se ndërtimet të cilat janë duke u zhvilluar kohëve të fundit janë mjaft shqetësuese; ato të cilat kanë leje ndërtimi mbi 80% nuk i janë përmbajtur lejes së ndërtimit ndërsa një numër shumë i madh i ndërtimeve tjera janë pa kurrfarë leje të ndërtimit. Shërbimi i DUPH-së është i shqetësuar sidomos në lokacionet për të cilat disponon me plane rregulluese (Prevallë, Jani Mëhallë, Lakuriqi, Dardania etj) ndërsa në brendinë e tyre ndërtohet duke mos ju përmbajtur planeve rregulluese”.

*Qyteti i kulturës pa politika kulturore* – Në takimin me përfaqësues të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, monitoruesit kanë evidentuar disa të meta në punën e këtij sektori. Buxheti total për tre sektorët e kësaj drejtorie për vitin 2012 në kategorinë e subvencioneve është 115 mijë euro; ku deri më tani janë shpenzuar 59 mijë e 150 euro, ndërsa në këtë kategori nga buxheti i këtij viti janë paguar 30 mijë euro burgje nga kategoria e

subvencioneve. Një nga të metat kryesore të sektorit të kulturës në Prizren është mungesa e Strategjisë për Zhvillimin e Kulturës. Për më shumë, qeveria lokale e Prizrenit nuk ka planifikim dhe hartim adekuat të politikave kulturore, ndërsa buxheti për sektorin e kulturës hartohet pa konsultim me komunitetin artistik dhe kulturor të qytetit.

*Auditori konfirmon shqetësimet e shoqërisë civile për keqmenaxhim financiar* – Raporti 2011 për komunën e Prizrenit i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm konstaton se komuna nuk ka arritur ta harmonizoj plotësisht buxhetin me dinamikën e shpenzimeve në periudha kohore, si dhe nuk ka vendosur mekanizmat e duhur të kontrollit mbi të hyrat vetjake. Në 60 mostra të testuara nga Auditori, që mbulojnë mbi 6 milion euro të pagesave të shpenzimeve përmes procedurave të prokurimit, është vërejtur se në 17 mostra komuna ka ndërmarrë procedurat e prokurimit të cilat nuk janë në pajtim me Ligjin mbi Prokurimin Publik. Zhvillimi i procedurave të prokurimit, pasi aktivitetet të jenë kryer, është një praktikë që nuk njihet nga ligji dhe si e tillë nuk duhet të ndodhë. Gjithashtu, kryerja e pagesave pa arritjen e objektivave të kontratës, flet për një performancë të keqe financiare, sipas raportit të Auditorit për komunën e Prizrenit.

*Degradimi urban i qytetit (hetime)* – Në njërën nga kërkesat për qasje në dokumente publike, nga ekzekutivi i komunës janë kërkuar lejet ndërtimore për objektet e banimit kolektiv nga viti 2007, bashkë me dëshmitë dhe dosjet e këtyre projekteve për të parë nëse ato janë realizuar konform lejeve ndërtimore. Në përgjigjen e Drejtorisë së Urbanizimit dhe Planifikimit Hapësinor për këtë kërkesë është dhënë njoftimi se “të gjitha dosjet e lëndëve të objekteve kolektive gjenden në Institucionin



Policor” (bashkëngjitur letra e kësaj drejtorie). Një ditë më pas ky lajm u konfirmua edhe nga Prokuroria e Qarkut në Prizren, e cila ka autorizuar hetuesit përkatës të Policisë së Kosovës që të nisin hetimet në lidhje me dyshimet për parregullsitë në ndërtimin e objekteve të banimit kolektiv dhe tejkalinin e planeve urbanistike në zonat e ndryshme të qytetit.

*Degradimi urban i qytetit – raste konkrete (objekte të banimit kolektiv)* – Si kontribut shtesë në përpjekjet për të sjellë rend urbanistik në Prizren, janë ofruar fakte të reja të parregullsive urbanistike. Monitoruesit dhe aktivistët e organizatës kanë evidentuar tejkalime dhe mosrespektime të shumta të planeve rregullative urbane nga ndërtuesit e objekteve të banimit kolektiv. Pos mungesës së sigurisë gjatë kryerjes së punimeve ndërtimore, segment që nuk monitorohet nga ekzekutivi komunal, këta investitorë shkelin edhe planet rregullative të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Prizrenit. Edhe përkundër miratimit të planeve rregulluese, janë evidentuar shumë tejkalime në bazë dhe etazhitet, si dhe mosrespektim i normave të tjera ligjore që rregullojnë fushën e ndërtimeve kolektive. Në një tjetër rast konkret të publikuar, pos uzurpimit të pronës publike nga investitori, në të njëjtin vend punimet vazhdojnë të kryhen pa lejen ndërtimore nga ekzekutivi komunal.

*Degradimi urban i qytetit – raste konkrete (Qendra Historike)* – Deri më tani janë identifikuar disa punime që janë kryer në kundërshtim me kriteret e ndërtimit dhe ndërhyrjes për Qendrën Historike të Prizrenit, si dhe në shpërputhje me lejen e punës së lëshuar nga autoritetet komunale. Konkretisht, monitoruesit e EC Ma Ndryshe kanë konstatuar se shkeljet më flagrante në këtë zonë janë

punimet në: Hotel Therandë, kafe “Hollywood”, ish shtëpia e Mallrave në Shatërvan, shtrimi i kubëzave nga Drejtoria e Shërbimeve Publike në sheshin Shatërvan (e realizuar pa pëlqimin e Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore në Prizren), ndërtimi i vrazhdë pranë shtëpisë së Shuaip Spahisë, ndërtimi i vrazhdë pranë objektit të IMMK-së, ndërtimi i disa hoteleve, etj. Shkeljet e kriterëve dhe lejeve të ndërtimit dhe ndërhyrjes në të shumtën e rasteve kanë të bëjnë me tejkalinin e bazës dhe etazhitetit të ndërtimit.

*Shpenzime marramendëse për udhëtime zyrtare* – Një dimension mjaft shqetësues i konkluzioneve të kryetarit është mënyra e shpenzimit të parasë publike për udhëtimet e zyrtarëve të komunës së Prizrenit. Brenda shtatë muajve të vitit 2012, nga buxheti i komunës janë shpenzuar mbi 18.000 euro për udhëtime zyrtare. Në një nga konkluzionet e këtij viti, kryetari lejon udhëtimin zyrtar dhe pagesën e mëditjeve për veten dhe gjashtë zyrtarë të lartë komunalpër pjesëmarrje në Festivalin V Ndërkombëtar të Valleve për Fëmijë, të mbajtur më 19 – 23 prill 2012 në Bejkozi të Republikës së Turqisë. Shuma totale e parasë publike të shpenzuar nga ky udhëtim është afro 3000 euro. Në një tjetër rast, kryetari i Komunës, më 18 prill 2012 ka miratuar konkluzionin për lejimin e ekskursionit/vizitës katër ditore për nëpunësit civil të Komunës së Prizrenit në Republikën e Shqipërisë për nder të Ditës Ndërkombëtare të Punës (1 Maj). Realizimi i këtij ekskursioni, buxhetit të Komunës i ka kushtuar 5.624 euro.

*Shpenzimi i pakontrollë i parasë publike* – Ndonëse e paralajmëruar disa herë nga shoqëria civile që të ketë kujdes me kategoritë e ndieshme buxhetore, qeveria lokale e Prizrenit edhe gjatë periudhës së parë të vitit fiskal 2012

nuk ka hezituar që në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve të shpenzoj afro 650.000 euro. Kabineti qeverisës i kryetarit të Komunës, në periduhën përkatëse ka shpenzuar mbi 112.000 euro për karburante për vetura, ndërsa për mirëmbajtjen dhe riparimin e tyre janë shpenzuar afro 32.000 euro. Një nga sjelljet më të papranueshme të zyrtarëve komunalë vazhdon të jetë edhe mënyra e përdorimit të telefonit zyrtar, pasi që monitorimi zbulon se për shpenzime të telefonisë mobile për periudhën gjashtë mujore janë shpenzuar mbi 15.000 euro. Për botimet dhe publikimet janë shpenzuar mbi 47.000 euro, derisa për drekat zyrtare dhe manifestimet e ndryshme afro 31.000 euro.

*Shpenzimet e luksit v gjendja socio-ekonomike e qytetarëve* – Një dëshmi e prekshme e pabarazisë së madhe sociale që ekziston në Prizren dhe e shpenzimeve të shfrenuara të parasë publike nga qeveria lokale është kujdesi që kjo qeveri u tregon pacientëve të sëmurë dhe në kushte të vështira ekonomike për tretman adekuat mjekësor. Kohë pas kohe, kryetari i Komunës merr vendime për t'i ofruar ndihmë financiare kësaj kategorie të qytetarëve, ndërsa shuma maksimale që i ofrohet një patienti është 300 euro. Edhe në vendimet për t'iu ndihmuar familjeve që jetojnë me asistencë sociale, qeveria lokale intervenon me shuma modeste. Mirëpo, kur bëhet fjalë për privilegjet e zyrtarëve komunalë – si telefoni, udhëtime, karburante, dreka – nuk vlen parimi i shpenzimit modest dhe kursimtar të parasë publike. Ndërsa ky përvetësim dhe devalvim i parasë publike nuk është fenomen i vitit 2012. Për shmebull, shpenzimet e udhëtimeve zyrtare në vitin 2010 kanë qenë 110.000 euro, ndërsa në vitin 2011 afrë 75.000 euro; për derivate dhe lëndë djegëse në vitin 2010 janë shpenzuar 717.000 euro, ndërsa në vitin 2011 rreth

713.000 euro; shpenzimet e reprezentacionit në vitin 2010 kanë qenë 84.000 euro, ndërsa në vitin 2011 – 91.000. Kjo praktikë e shpenzimeve është në kundërshtim me realitetin social dhe ekonomik të qytetarëve të Prizrenit. Sa më të shfrenuara të jenë shpenzimet e zyrtarëve të qeverisë lokale për privilegjet e tyre, aq më e papërbalueshme do të jetë shporta ditore e ushqimit për familjet e Prizrenit. Ne tashmë i jetojmë dy realitete në Prizren, atë të zyrtarëve të qeverisë lokale që shijojnë privilegjet e pushtetit dhe të dytën, jetën e qytetarëve të Prizrenit, ku çdo i dytë qytetar jeton në varfëri, ndërsa cdo i pesti në varfëri ekstreme. Dhe e gjithë kjo, në emër të qytetarëve dhe përmes taksava të tyre.

## VI. Ndikimi i projektit

Faza e parë, gjashtëmujore e projektit ka prodhuar disa rezultate të mira, të cilat janë indikatorë pozitiv për efekte më të mëdha në fazat e ardhshme të projektit. Në të njëjtën kohë, rezultatet e para janë dëshmi e mirë për nevojën e monitorimit permanent dhe intensiv të ekzekutivit komunal në Prizren. Ndikimi i fazës së parë të projektit është vërejtur në mbulesën mediale të ofruar për të gjeturat dhe aktivitetet e projektit, interesimin e qytetarëve për të raportuar raste të keqpërdorimit të pozitës zyrtare, nisjen e hetimeve në urbanizëm, interesimin e Ministrisë së Kulturës për situatën e krijuar në Qendrën Historike dhe numrin e vizitave (klikimeve) në web-faqen e projektit.

*Mbulesa mediale* – Të gjeturat dhe aktivitetet e projektit janë raportuar gjerësisht nga të gjitha mediat e Kosovës, përfshi televizionet lokale, televizionet qendrore (ndonëse më rrallë), gazetatat ditore dhe portalet e internetit.

Komunikatat e rregullta dhe konferencat për media janë mbuluar rregullisht nga televizionet lokale të Prizrenit, kryesisht në kuadër të edicioneve qendrore të lajmeve. Për më tepër, të gjeturat dhe raportet e monitorimit kanë shërbyer për përgatitjen e kronikave të shumta televizive në kuadër të emisione të ndryshme, ndërsa stafi i projektit dhe i organizatës është ftuar në disa emisione për të diskutuar rreth monitorimit dhe transparencës në komunën e Prizrenit. Të gjeturat e monitorimit, kohë pas kohe janë pasqyruar edhe nga edicionet qendrore të lajmeve në televizionet qendrore të Kosovës. Për më tepër, temat si degradimi urban i Qendrës Historike të Prizrenit, shpenzimet e udhëtimit të zyrtarëve komunal, kanë nxitur televizionet qendrore për të përgatitur kronika të veçanta televizive në kuadër të emisioneve të ndryshme (psh. programet e mëngjesit). Një tjetër dimension i mbulesës së gjerë mediale kanë qenë gazetar ditore të Kosovës, të cilat kanë raportuar rregullisht mbi të gjeturat e monitorimit. Përfundimisht, portalet e lajmeve në internet kanë qenë mjaft reaktive në publikimin e të gjeturave të monitorimit në orët e para pas publikimit të komunikatave.

*Raportimi qytetar* – Një nga të arriturat e papritura të projektit ka qenë vullneti i qytetarëve të Prizrenit për të raportuar në projekt raste të keqpërdorimit të detyrës zyrtare. Një rast i paraqitur nga qytetarët është proceduar në Agjencinë Kundër Korrupsionit, ndërsa rasti i dytë, që është në fazën e fundit të hulumtimit, ka të bëjë me shkelje të rëndë ligjore. Këto raste na kanë inkurajuar që në kuadër të projektit të kirjojmë një segment të posaçëm për raportim qytetar. Për këtë arsye, gjatë fazës së dytë të projektit, EC Ma Ndryshe i fton të gjithë qytetarët e Prizrenit që të bëhen pjesë e projektit për monitorimin e qeverisjes

lokale, duke i raportuar rastet e qeverisjes së keqe, keqmenaxhimit, mungesës së transparencës, korrupsionit, mashtrimit, konfliktit të interesit apo formave të tjera të keqpërdorimit të pozitës nga zyrtarët apo nëpunësit civilë të komunës së Prizrenit. Raportimi mund të bëhet për të gjitha rastet e keqpërdorimit të pozitës zyrtare në shërbimin civil, ekzekutivin (Kryetari dhe drejtoritë komunale), Kuvendin e Komunës dhe ndërmarrjet publike.

*Hetime në urbanizëm* – Zhvillimi më inkurajues i periudhës gjatë mujore ishte nisja e hetimeve nga Prokuroria e Qarkut në Prizren, e cila ka autorizuar hetuesit përkatës të Policisë së Kosovës që të nisin hetimet në lidhje me dyshimet për parregullsitë në ndërtimin e objekteve të banimit kolektiv dhe tejkalimin e planeve urbanistike në zonat e ndryshme të qytetit. EC Ma Ndryshe shpreh mirënjohjen e saj për këtë iniciativë të organeve të drejtësisë dhe rendit, e cila ka ndodhur pas raportimeve të rregullta të organizatës muajve të fundit në lidhje me parregullsitë urbanistike në Prizren. Në mënyrë që kjo të mos mbetet një iniciativë në tentativë, EC Ma Ndryshe apelon për një bashkërendim të veprimeve nga organet përkatëse, në mënyrë që shkelësit e planeve rregullative urbane dhe ligjeve të trashëgimisë kulturore dhe planifikimit hapësinor të përgjigjen para drejtësisë.

*Zotimi i Ministrisë të Kulturës* – Raporti mbi degradimin e Qendrës Historike me dhjetë raste konkrete të shkeljes së lejeve të ndërtimit, ku konstatohet edhe fakti se vetëm në gjashtë mujorin e parë të vitit 2012 nga Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore në Prizren janë lëshuar 62 pëlqime për ndërtim apo ndërhyrje në Qendrën Historike të Prizrenit, ka nxitur reagime brenda Ministrisë së Kulturës,

Rinisë dhe Sportit. Ministri i MKRS ka shfaqur interesim personal për këtë fenomen, ndërsa publikisht ka njoftuar se nga Instituti në Prizren ka kërkuar raport mbi gjendjen e trashëgimisë kulturore në Qendrën Historike të Prizrenit. Për më tepër, gjatë një debati publik mbi Ligjin e ri të Trashëgimisë Kulturore, ministri është zotuar se prioritet kryesor i tij në ditët dhe javët në vijim do të jetë mbrojtja e trashëgimisë kulturore nga ndërhyrjet e egra të ndërtuesve ilegalë.

*Vizitat në web-faqe* – Numri i vizitorëve të web-faqes së projektit ([www.online-transparency.org](http://www.online-transparency.org)) ka shënuar rritje konstante. Nga disa dhjetëra vizita në javë, muajin e fundit numri i vizitorëve ka qenë mbi 1000, që nënkupton disa qindra klikime në javë. Paralelisht me web-faqen, EC Ma Ndryshe e shfrytëzon edhe web-faqen e saj zyrtare dhe faqen e saj zyrtare në Facebook për të publikuar të gjeturat dhe komunikatat e minorimit. Faqja zyrtare e organizatës në Facebook ka një trafik prej 4000 vizitorësh në javë.

## VII. Rekomandime të përgjithshme (transparenca)

Për përmirësimin e nivelit të transparencës në qeverisjen lokale të Prizrenit, aktorët relevantë (komuna e Prizrenit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Prokuroria e Qarkut, Shoqëria Civile dhe mediet) sugjerohen që në mënyrë urgjente të ndërmarrin këto veprime:

- Të amendamentohet Rregullorja për Transparencë dhe përfshihen në mënyrë eksplicite obligimet e kryetarit dhe ekzekutivit komunal në raport me transparencën lokale,

- Të anulohet vendimi dhe të ndërpritet praktika jotransparente e takimeve të mbyllura të kryetarit të komunës me drejtorët komunalë,
- Të ndërmerren masa ndëshkuese ndaj zyrtarëve komunalë që nuk ofrojnë qasje në dokumente publike në pajtim me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike,
- Të publikohen të gjitha aktet dhe vendimet komunale në formën e tyre preliminare (gjatë procesit të hartimit) në web-faqen zyrtare të komunës,
- Të vendosen të gjitha aktet dhe vendimet komunale në formën e tyre përfundimtare në web-faqen zyrtare të komunës, menjëherë pas miratimit të tyre,
- Të amendamentohet Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, duke e fuqizuar Kuvendin e Komunës në raport me mbikëqyrjen e punës së kryetarit të komunës,
- Të forcohet angazhimi i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në komunën e Prizrenit dhe të ngriten kapacitetet e zyrtarëve të komunës për respektimin e ligjit (parandalimi),
- Të promovohen rregullisht mekanizmat e pjesëmarrjes qytetare dhe të rritet interesimi i qytetarëve për të marrë pjesë në konsultime publike,
- Të rritet numri i organizatave të shoqërisë civile që monitorojnë punën e organeve të komunës së Prizrenit (me theks të veçantë në monitorim sektoral)
- Të sigurohet përfshirja substanciale e qytetarëve në hartimin e buxhetit vjetor komunal dhe të forcohen procedurat e jetësimit të kërkesave dhe nevojave të qytetarëve në raport me buxhetin,
- Të raportohen në mënyrë të rregullt në mediet lokale të Prizrenit, të gjitha veprimet

- që bien ndesh me qeverisjen e mirë dhe transparente,
- Të ndërmerren hetime nga Prokuroria e Qarkut për të gjitha rastet e raportuara nga organizatat që e monitorojnë punën e komunës dhe për të gjeturat e Raportit të Auditorit të Përgjithshëm,
  - Të funksionalizohet Zyra për Informim e komunës për t'i ofruar qytetarëve informacion orientues dhe për të parandaluar mbingarkesat në administratën komunale,
  - Të themelohet Zyra për Hulumtime dhe Opinion Publik, e cila do të bëj përcjelljen permanente të disponimit të qytetarëve për politika të ndryshme publike.

### VIII. Rekomandime specifike (sektorale)

Në bazë të të gjeturave të deritanishme në sektorët specifik të qeverisjes lokale, EC Ma Ndryshe ka rekomanduar ndërmarrjen e një numri veprimesh për të përmirësuar nivelin e transparencës, performansën e qeverisjes, menaxhimit financiar në këta sektorë: urbanizëm, inspektorat, kulturë, arsim, shëndetësi, buxhet. Për shkak të përgjegjësisë së përbashkët në shumë raste, rekomandimet u drejtohen organeve komunale, institucioneve qendrore dhe institucioneve të rendit dhe drejtësisë.

*Kryetari i Prizrenit të ketë Plan të Punës* – Me qëllim të ngritjes së cilësisë së mirëqeverisjes dhe për të pasur një transparencë me të madhe lidhur me dinamikën e realizimit të objektivave të qeverisë lokale, Kryetari i Komunës së Prizrenit sa më parë të fillojë me hartimin e Planit të Punës për vitin 2013 dhe publikimin e tij për publikun e gjerë.

*Të mbikëqyret menaxhimi financiar nëpër shkolla* – Menaxhimi i financave nga ana e drejtorëve të shkollave lë hapësirë të madhe për menaxhim joefikas dhe shpërdorim të parasë publike. Andaj, Drejtoria e Arsimit duhet të ketë një kontroll më efektiv mbi drejtorët e shkollave sa i përket menaxhimit të financave si dhe të vazhdojë të trajtojë drejtorët në fushën e menaxhimit të financave.

*Të hetohen rastet e prishjeve në objektet e reja shkollore* – Të hetohen të gjitha rastet e prishjeve të shpejta në objektet e reja shkollore dhe të obligohen operatorët ekonomik që të sanohen prishjet.

*Të sanohet gjendja në ofrimin e shërbimeve mjekësore* – Qeveria lokale bashkë me stafin drejtues të institucioneve të shëndetit primar duhet të ndërmarrin veprime të menjëhershme për sanimin e gjendjes në ofrimin e shërbimeve primare shëndetësore për qytetarët e Prizrenit.

*Të rrenohen ndërtimet jashtë kriterëve* – Të inicohen procedurat për rrenimin e të gjitha ndërtimeve pa leje dhe atyre që janë bërë jashtë kriterëve të ndërtimit, sidomos në Qendrën Historike të Prizrenit. Gjithashtu, kryetari i Komunës së Prizrenit duhet të mbajë përgjegjësinë finale për ndërtimin e objekteve të banimit kolektiv jashtë kriterëve urbanistike dhe të ndërmarrë veprime të menjëhershme për rrenimin e të gjitha objekteve të banimit kolektiv që nuk i respektojnë lejet e ndërimit dhe planet rregullative urbane. Gjithashtu apelojmë për një bashkërendim të veprimeve nga organet e drejtësisë, komunale dhe qendrore, në mënyrë që shkelësit e planeve rregullative urbane dhe ligjeve të trashëgimisë kulturore dhe planifikimit hapësinor të përgjigjen para drejtësisë.

*Koordinim mes urbanizmit dhe inspektorarit për normalizimin e gjendjes në Qendrën Historike –* Qeveria lokale e Prizrenit, urgjentisht të ndërmarrë veprime të nevojshme në drejtim të normalizimit të gjendjes në Qendrën Historike të Prizrenit, në pajtim me Planin e Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit dhe planet rregullative urbane të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Prizrenit. Në rradhë të parë, kërkojmë që Drejtoria Komunale e Urbanizmit të veprojë në pajtueshmëri të plotë me mendimin e lëshuar nga Instituti i Monumenteve, ndërsa nga Drejtoria e Inspektorateve që të monitorojë me rigjeditet maksimal përmbajtjen me kriteret e parapara në lejen e ndërtimit. Në rast të identifikimit të shkeljeve gjatë fazës së ekzekutimit të punimeve, ekzekutivi i komunës (me theks të veçantë kryetari i komunës) duhet të ndërmarrin veprime konkrete parandaluese, ndërsa në rast të vazhdimit të punimit, edhe veprime ndëshkuese ndaj personave që nuk i respektojnë kriteret e ndërtimit.

*IMMK Prizren të jetë më rigjide në dhënien e pëlqimeve –* Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës në Prizren të jetë më rigoroz në dhënien e pëlqimeve për punime në Qendrën Historike të Prizrenit, si dhe të jetë më aktiv në monitorimin e ekzekutimit të punimeve në këtë Qendër, duke e përdorur autoritetin qendror, respektivisht Ministrinë e Kulturës (pjesë e së cilës është) dhe qeverinë e Kosovës për veprime parandaluese dhe ndëshkuese ndaj komunës dhe shkelësve të tjerë të kriterëve dhe lejeve të ndërtimit dhe standardeve të trashëgimisë kulturore në Prizren.

*Të hartohet Strategjia për Kulturën –* Sa më parë të nisë hartimi i Strategjisë për Kulturën dhe të themelohet dialogu i strukturuar mes

qeverisë lokale dhe shoqërisë civile për hartimin e politikave adekuate kulturore.

*Të zbatohen rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm –* Të zbatohen me përpikmëri rekomandimet që dalin nga raporti i auditimit për vitin 2011, e që janë në përputhje edhe me vërejtjet dhe rekomandimet e organizatave të shoqërisë civile që e monitorojnë punën e komunës së Prizrenit. Menaxhimi i parasë publike është elementi më i rëndësishëm i qeverisjes së mirë dhe demokratike. Ndërsa, vendimmarrja transparente është parakusht i domosdoshëm për menaxhim të mirë të parasë publike dhe luftim të aferave korruptive në qeverisjen lokale.

*Të reduktohen shpenzimet për udhëtime zyrtare të panevojshme –* Kryetari i Komunës të jetë i kujdesshëm në shpenzimin e parasë publike në kategorinë e udhëtimeve zyrtare. Kryetari i komunës ka obligim ligjor dhe moral që të menaxhojë me përgjegjësi paratë e taksapaguesve të Prizrenit. Prandaj, në marrjen e vendimeve për shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, kryetari i Komunës duhet t'i ketë parasysh standardet e qeverisjes së mirë dhe të menaxhimit adekuat me paranë publike. Në të njëjtën kohë, kryetari duhet të ketë parasysh se menaxhon me buxhetin e një komune me nivel mjaft të dobët të zhvillimit ekonomik dhe me tregues alarmant të niveleve të varfërisë (dhe varfërisë ekstreme), papunësisë dhe rasteve sociale.

*Të ndërpritet praktika e përvetësimit dhe devalvimit të parasë publike –* Kryetari i Komunës të ndalojë praktikën e përvetësimit dhe devalvimit të parasë publike. Një praktikë e këtillë po e thellon diskriminimin dhe pabarazinë sociale në Prizren, që është në kundërshtim të plotë me mandatin e tij si menaxher i zhvillimit të qytetit. Gjithashtu, i



rekomandojmë Kuvendit të Komunës së Prizrenit dhe Kryesuesit që sa më parë të kërkojnë raportet financiare nga ana e kryetarit të Komunës për periudhën gjashtëmujore 2012. Qëllimi i këtij raportimi duhet të jetë rishqyrtimi i vijave buxhetore për vitin 2012 dhe shkurtimi i shpenzimeve në kategoritë e lartpërmendura.

### IX. Faza e dytë

Në muajin shtator fillon faza e dytë e projektit “Transparenca online e komunës së Prizrenit”. Metodologjia e monitorimit dhe publikimit do të ketë disa ndryshime, kryesisht si pasojë e rritjes së kapaciteteve hulumtuese dhe mbulimit të më shumë sferare të qeverisjes lokale. Projekti do të ketë numër më të madh të monitoruesve, të cilët do të monitorojnë në mënyrë permanente qeverisjen dhe vendimmarrjen lokale. Fokusi i monitorimit do të vazhdojë të jetë urbanizmi, ndërsa paralelisht me sferat e tjera do të monitorohet edhe shpenzimi i buxhetit vjetor (në mënyrë permanente). Gazetarët dhe opinionistët do të vazhdojnë të marrin komunikata të rregullta (javore ose dy-javore), ndërsa çdo tre muaj do të publikohet nga një raport më i detajuar mbi një sektor të caktuar të qeverisjes lokale. Të gjitha raportet do të publikohen përmes debateve që do të tubojnë të gjitha palët e interesit kur bëhet fjalë për qeverisjen transparente dhe demokratike. Raportimi online (përmes web-faqes së projektit) do të jetë forma më e shpeshtë e publikimit të gjeturave. Monitoruesit dhe stafi i projektit do të kujdesen që web-faqja e projektit të përditësohet në baza javore (me raste edhe në baza ditore), për të shërbyer si një platformë e

informimit permanent mbi qeverisjen lokale në Prizren.

Një nga elementet e reja të fazës së dytë të projektit do të jetë edhe përfshirja e qytetarëve në ngritjen e nivelit të transparencës lokale. Përmes raportimit direkt, qytetarët do t’u ofrojnë monitoruesve dhe stafit të projektit rastet e tyre konkrete që kanë të bëjnë me keqpërdorimin e detyrës zyrtare. Identiteti i raportuesit(es) dhe të dhënat personale të tij/saj do të jenë konfidenciale dhe nuk do të publikohen. Raportuesi(ja) mund të zgjedh edhe mundësinë e raportimit anonim. Raportimi do të bëhet përmes formës online dhe përmban këto detaje: Titulli i rastit, Përshkrimi i detajuar i rastit, Data kur ka ndodhur rasti, Organi komunal i përfshirë në rast, Dokumente (dëshmi) dhe foto për t’u bashkëngjitur dhe Informata shtesë.

### X. Falënderim

EC Ma Ndryshe i është thellësisht falenderuese Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur, që ka ofruar mbështetje financiare për fazën e parë (testuese) të projektit “Transparenca online e komunës së Prizrenit”. Mbështetja e KFOS ka qenë thelbësore në konsolidimin e këtij projekti, i cili gjashtë muaj pas fillimit, ka arritur të dëshmojë qëndrueshmëri dhe të arsyetojë nevojshmërinë për monitorim të rregullt të transparencës lokale. Gjithashtu, i falenderohemi Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë, që ka vlerësuar suksesin e fazës së parë të projektit dhe ka vendosur të mbështesë financiarisht projektin duke filluar nga muaji shtator 2012.



## EC MA NDRYSHË

Organizata jo-qeveritare “Emancipimi Civil Ma Ndryshe” u themelua në mars të vitit 2006. Qëllimet kryesore të organizatës janë: promovimi i qytetarisë aktive dhe pjesëmarrëse dhe ngritja e vetëdijes qytetare për mbrojtjen dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore. EC Ma Ndryshe është ndër themelueset dhe përfaqëson Kosovën në Rrjetin e Europës Juglindore të organizatave që merren me trashëgimi kulturore – SEE Heritage Network. Gjithashtu, është anëtare themeluese e Forumit të Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit, Rrjetit të Organizatave të Kulturës në Prizren dhe Rrjetit të Organizatave të Pavarura të Kulturës në Kosovë – Forumi Kulturor.

EC Ma Ndryshe, që nga themelimi më 2006 është duke ushtruar presion direkt ndaj qeverisë lokale në Prizrenit për të krijuar qasje shoqërisë civile dhe qytetarëve për bashkëvendimmarrje. Përveç pjesëmarrjes direkte në proceset e konsultimeve publike, EC Ma Ndryshe ka avokuar rregullisht për respektimin e obligimeve ligjore për konsultime publike, përfshirjen sa më të gjerë komunitare në konsultime publike dhe përfshirjen e shqetësimeve dhe kërkesave të komunitetit në dokumentet e politikave publike. Për të ofruar një model konkret të konsultimit publik, EC Ma Ndryshe ka realizuar projektin “Forumet e Hapura Qytetare”, ku instrumenti i forumit është promovuar si model funksional i pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje. Për më tepër, përmes Forumit të Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit, EC Ma Ndryshe ka ngritur një platformë avokuese për komunitetin kulturor të qytetit duke e shndërruar Forumin në një pjesëmarrës aktiv të formulimit të politikave kulturore në nivel lokal.

Në emër të promovimit të mekanizmave të demokracisë së drejtpërdrejtë, EC Ma Ndryshe ka qenë pjesë e dy Peticioneve në qytetin e Prizrenit, njëri për të parandaluar rrënimin e objektit të kinemasë së qytetit dhe tjetri për të kundërshtuar projekt-ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit. Njëra ndër veprimet konkrete me të rinjtë e qytetit ka qenë bashkëpunimi me Festivalin Dokufest për të shfaqur filma dokumentarë nxënësve të shkollave të mesme të qytetit. Temat e dokumentarëve kanë përfshirë një spektër të gjerë të edukimit qytetar me qëllim përgatitjen e gjeneratave të ardhshme që do të jenë qytetarisht të përgjegjshme dhe aktive. Aktivizmi është edhe një ndër parimet udhëheqëse të veprimit të brendshëm të organizatës. Përmes Grupit të Vullnetarëve Aktiv (grup që funksionon brenda EC Ma Ndryshes) organizata ka promovuar aktivitetin vullnetar në shumë fusha, e posaçërisht në kulturë dhe trashëgimi kulturore.

*Projektet kryesore:* Vullnetarët e Kulturës (2012 – 2013), Pjesëmarrja qytetare në hartimin dhe zbatimin e politikave kulturore në komunën e Prizrenit (2012 – 2013), Transparenca online e komunës së Prizrenit (2012), Roli i shoqërisë civile në promovimin e trashëgimisë kulturore (projekt rajonal) 2011 – 2013, Një përrallë ballkanike, trashëgimia otomane në Ballkan (projekt rajonal) (2011 – 2013), Ngritja e vetëdijes kulturore tek të rinjtë përmes dokumenarëve (2010), Forcimi i veprimit qytetar për promovim dhe mbrojtje të trashëgimisë kulturore (2009), Platforma “Culture 2013” (2008 – 2009), Kampet e Restaurimit (2007, 2008 & 2009), Forumet e Hapura Qytetare (2007), Ditët e Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2006, 2007 & 2008), Zambaku i Prizrenit 2006. *Publikimet:* Silent Balkan, film dokumentar i projektit “A Balkan Tale” (2012), Dokument Strategjik mbi Organizimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2008), Trashëgimia Kulturore dhe Turizmi Kulturor në Prizren (2008), Hapësirat Kulturore në Kosovë (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2008), Prizreni në Retrovizore, krahasim i fotografive të vjetra dhe të reja të Prizrenit (2009), Vullnetarizmi dhe Trashëgimia Kulturore (2009), Intervenimi me kosto të ultë (2009), Jeta kulturore në komunën e Prizrenit (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2010-2011), Silent Balkan, film dokumentar i projektit “A Balkan Tale” (2012).